

AGJENCIA E INTELIGJENCËS FINANCIARE

TIPOLOGJITË TË ORGANIZATAVE JO-FITIMPRURËS NË FINANCIMIN E
TERRORIZMIT (FT) DHE FINANCIMIN E PËRHAPJES SË ARMËVE TË DËMTIMIT NË
MASË (ADM)

Janar 2026

HYRJE

Pastrimi i parave (PP), financimi i terrorizmit(FT) dhe financimi i përhapjes së të armëve të dëmtimit në masë (ADM), përbëjnë kërcënime serioze për sigurinë kombëtare, stabilitetin financiar dhe rendin ndërkombëtar. Në këtë kuadër, Organizatat Jo-Fitimprurëse (OJF), subjektet tregtare fasadë, shërbimet ndërmjetësuese dhe transaksionet pa praninë fizike të klientit paraqesin rreziqe të shtuara, për shkak të natyrës së tyre operacionale, flukseve financiare ndërkufitare dhe mundësisë për t'u keqpërdorur si mbulesë për veprimtari të jashtëligjshme.

Standardet ndërkombëtare të Grupit të Posaçëm të Veprimit Financiar (FATF), theksojnë nevojën për identifikimin, analizimin dhe kuptimin e tipologjive konkrete përmes të cilave grupet kriminale, organizatat terroriste ose financuesit e ADM shfrytëzojnë sektorë të caktuar, përfshirë OJF, Zyrat e Këmbimit Valutor (ZKV), kompanitë fasadë dhe profesionistët e shërbimeve financiare dhe ligjore. Njohja e këtyre skemave, shërben për forcimin e sistemeve të parandalimit, rritjen e efektivitetit të kujdesit të duhur dhe të zgjeruar ndaj klientit, si dhe për raportimin e transaksioneve të dyshimta në Agjencinë e Inteligjencës Financiare (AIF).

Ky dokument, paraqet një përmbledhje të tipologjive kryesore të evidentuara në praktikat kombëtare dhe ndërkombëtare, të shoqëruara me raste konkrete. AIF synon që nëpërmjet këtij dokumenti, të mbështesë institucionet financiare, autoritetet mbikëqyrëse, subjektet raportuese dhe profesionistët përkatës në identifikimin e treguesve të rrezikut, kuptimin e metodave të përdorura dhe përmirësimin e mekanizmave të parandalimit e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe të armëve të dëmtimit në masë (PPP/FT/ADM).

Përdorimi i kompanive fasadë për financimin e përhapjes së ADM, përbën një nga tipologjitë më të dokumentuara në analizat e shërbimeve të inteligjencës financiare dhe autoriteteve kompetente në nivel ndërkombëtar¹. Dokumenti paraqet disa tipologji të cilat përshkruajnë ngjarjet, pjesëmarrësit kryesorë, rrjedhën financiare dhe të mallrave, të përdorura në proceset e financimit të përhapjes së ADM, shpesh të ndërlidhura me financimin e terrorizmit.

¹ “Raporti për financimin e përhapjes së Armëve të Dëmtimit në Masë” i publikuar nga FAF në vitin 2008.

Tipologji nr.1: Mbështetja e financimit të ADM përmes pagesave me para në dorë dhe OJF-ve

Kjo tipologji lidhet me mbështetjen nga simpatizantë dhe përkrahës të përhapjes dhe financimit të ADM (individë dhe persona juridikë), përmes një rrjeti të Zyrave të Këmbimit Valutor (ZKV) ose përmes Organizata JO-Fitimprurëse (OJF). Në këtë rast, rrjedha kryesore e parave është me para në dorë, prandaj ZKV janë veçanërisht të ekspozuara ndaj rrezikut. Në rastin e OJF, programet e financimit të ADM mund të maskohen si veprimtari bamirësie, shpesh pa dijeninë e donatorëve, duke bërë që ata të financojnë “pa dashur” aktivitetet e përhapjes së ADM.

Tipologji nr.2: Ndërlidhja mes FT dhe ADM si kërcënim global

Lidhjet mes financimit të terrorizmit dhe financimit të ADM përbëjnë një kërcënim ndaj paqes dhe stabilitetit në nivel ndërkombëtar. Organizatat dhe grupet terroriste, apo edhe terroristët individualë, mbështesin financiarisht programe dhe veprimtari për zhvillimin e ADM, nëse kjo i shërben realizimit të qëllimeve të tyre radikale, të cilat bien ndesh me rendin kushtetues dhe politikat e shteteve, dhe çenojnë rendin dhe sigurinë në nivel ndërkombëtar individëve. Është e vështirë të identifikohen transaksionet që lidhen me financimin e terrorizmit (FT), pasi institucionet financiare shpesh anashkalohen. Në rastet kur ato përfshihen, zakonisht kësaj faze i paraprin “pastrimi” i fondeve të përfituara në mënyrë të jashtëligjshme (p.sh. nëpërmjet kontrabandës së gurëve dhe metaleve të çmuara, forma të ndryshme krimi të organizuar). Një metodë më e thjeshtë dhe në pamje të parë më legjitime, mund të lidhet me grumbullimin e burimeve të financimit përmes OJF dhe abuzimin e aktiviteteve të bamirësisë që ato mund të ofrojnë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Tipologji nr.3: Mbështetje për “persona të listuar” dhe shtete me programe të financimit të ADM

Ky rast tipologjik dhe ilustrimi përkatës, paraqet rolin dhe mundësinë e keqpërdorimit të OJF në mbledhjen e fondeve për FT dhe përhapjes së ADM. Në varësi të fushës së aktivitetit, nëpërmjet programit të saj një OJF mund të tërheqë një numër të madh donatorësh. Keqpërdorimi i mundshëm reflektohet në programe fiktive, duke i bërë të besojnë publikun e gjerë dhe donatorët, se po bëjnë një vepër të mirë, ndërkohë që pa dijeninë e tyre po financojnë terrorizmin. Nëpërmjet veprimtarive të mëtejshme, OJF mbështet “persona të shpallur” si financues të terrorizmit dhe në mënyrë të tërthortë, një shtet me program të përhapjes së ADM, përmes korrierëve të parave.

Tipologji nr.4: Kompanitë fasadë si mekanizëm maskimi

Nëpërmjet fshehjes së pronarët të vërtetë, kompanitë fasadë, kryejnë veprimtari të jashtëligjshme ndërkohë që ruhet pamja e një aktiviteti të ligjshëm biznesi. Kompanitë “fasadë” i shndërrojnë mallrat me vlerë (p.sh. automjetet, gurët dhe metalet e çmuara) në investime që krijojnë të ardhura dhe fitime, të cilat më pas i kanalizojnë përmes transfertave të ligjshme, në një OJF që është e lidhur me organizata ose grupe terroriste që mbështesin financimin e përhapjes së ADM.

Tipologji nr.5: Abuzimi me aktivitetin e OJF për financimin e terrorizmit

Një OJF, mbante një llogari në një bankë vendase për të mbledhur donacione publike. Transaksionet bankare evidentuan se në llogari bëheshin depozita me para në dorë nga persona të ndryshëm dhe paralelisht, lëshoheshin çeqe në favor të personave të ndryshëm. Rezultoi se, ndër

përfituesit e çeqeve, ishte dhe shtetasi 'H' (kryetar i këshillit drejtues të OJF), që përbënte një tregues dyshimi të lidhur me rastin.

Nga analiza e Njësisë së Inteligjencës Financiare (NjIF), u evidentua se në llogarinë e OJF objekt dyshimi, gjatë periudhës 2016 – 2021, ishin kryer depozitime me para në dorë, nga persona të ndryshëm me përshkrimin donacione, në vlerën totale 154,934 USD. Aktivitetet debitorë në lidhje me këtë shumë përfaqësoheshin kryesisht nga çeqe të paguara në favor të personave të ndryshëm, mes të cilëve edhe shtetasi 'H'.

Duke marrë parasysh sa më sipër dhe faktin që ishte i paqartë qëllimi i lëshimit të çeqeve nga llogaria e OJF në favor të 'H', NjIF kërkoi nga organet kompetente të kryenin verifikime të metejshme. Nga informacioni i vënë në dispozicion rezultoi se drejtuesit e grupit terrorist, të cilët kishin braktisur vendin, zhvillonin mbledhje në të cilat kishin planifikuar një skemë për të siguruar mbështetjen materiale të nevojshme për të financuar aktivitetin e tyre të jashtëligjshëm jashtë vëndit, duke dëmtuar interesin kombëtar dhe sigurinë ekonomike, nëpërmjet sulmeve ndaj punonjësve, ushtrisë dhe policisë me synimin e përmbyesjes së rendit kushtetues. Për këtë qëllim ata ngarkuan anëtarë të grupit dhe disa elementë të lidhur me ta brenda vëndit, përfshirë kryetarin e këshillit drejtues të OJF së dyshuar dhe ranë dakord për të shfrytëzuar fitimet e subjekteve ekonomike të grupit dhe mbledhur donacione nga elementët e grupit brenda vëndit, për të siguruar mbështetje logjistike, si armë dhe eksplozivë, për realizimin e aktivitetit terrorist.

Tipologji nr. 6: Anëtarë të këshillit drejtues të OJF të përfshirë në aktivitete me vënde me rrezik të lartë për financimin e terrorizmit.

Banka vendase X, i paraqiti NjIF një raport në lidhje me dyshimet për një OJF, duke deklaruar se, kur organizata aplikoi për hapjen e një llogarie bankare, nuk ishin bashkëlidhur dokumentet e kërkuara, konkretisht miratimi nga rregullatori i organizatave. Kur banka konfirmoi kërkesën për dokumentacion plotësues për procedurat e hapjes së llogarisë nga organizata, kjo e fundit u tërhoq nga kërkesa për hapjen e llogarisë. Aplikimi për hapjen e llogarisë u shoqërua me disa pyetje nga personat e autorizuar për firmosje dhe administrim të llogarisë së OJF lidhur me procedurat e bankës dhe kujdesin e shtuar ndaj klientit, gjë që shtoi dyshimet e bankës mbi natyrën e veprimtarisë së organizatës.

NjIF filloi analizën financiare dhe kërkoi në bazën e saj të dhënave, por nuk gjeti asnjë informacion për OJF, për personat e autorizuar ose administratorët e saj. Më pas u kontaktua autoriteti mbikëqyrës i OJF, i cili raportoi se organizata ishte e regjistruar pranë tij. Megjithatë, kur u kërkua informacion mbi bilancet dhe llogaritë e OJF ose të administratorëve të autorizuar, nuk rezultoi asnjë e dhënë.

Nga verifikimet mbi lëvizjet e udhëtimit të anëtarëve të këshillit drejtues OJF, rezultoi se dy prej tyre kishin udhëtuar nga dhe drejt vendeve të klasifikuara me rrezik të lartë (territore ku ushtronin aktivitetin organizata terroriste të njohura ndërkombëtarisht).

Treguesit e dyshimit në këtë rast pasqyrohen në mosplotësimin e procedurave për hapjen e llogarisë bankare dhe ngurrimin për të ofruar informacionin e kërkuar, si edhe në udhëtimet e shpeshta drejt vendeve me rrezik të lartë. Për më tepër, të dyshuarit kanë qenë më herët në vënde me rrezik të lartë dhe në shtete të klasifikuara si qendra aktive të grupeve dhe organizatave terroriste. Nga hetimi dhe analiza e informacionit financiar për këta persona, rezultoi se ata nuk

kishin bilance, llogari bankare apo pasuri të tjera në banka apo në shtetin përkatës, çka tregon se po shmangnin veprimet përmes kanaleve formale shtetërore për të evituar ndjekjen e mundshme penale.

Për më tepër, ngurrimi i treguar nga këshilli drejtues i OJF, për hapjen e llogarisë dhe ofrimin e dokumentacionit të kërkuar si dhe tërheqja nga hapja e llogarisë, konfirmon synimin e tyre për të shmangur monitorimin në kuadrin e zbatimit të masave parandaluese për financimin e terrorizmit.

Tipologji nr.7: Falsifikimi i dokumenteve të një përfaqësuesi të OJF.

Një bankë vendase raportoi në NJIF, mbi dyshimin për falsifikim të dokumenteve të identitetit për një llogari bankare (një pasaportë e huaj e falsifikuar) të personit të autorizuar nga një OJF. Data e lëshimit të pasaportës, u shqyrtua dhe rezultoi se përkonte me një festë zyrtare, përveç mungesës së qartësisë së fotos personale në pasaportë.

Nga analiza e ndërmarrë nga NJIF rezultoi se:

- Bazuar në informacionin e paraqitur nga Departamenti i Pasaportave dhe Imigracionit, pasaporta e përdorur për hapjen e llogarisë ishte e falsifikuar.
- Personi i dyshuar drejtonte një organizatë bamirëse, anëtarësia e së cilës përfshin 41 persona, pjesë e të cilëve ishin dhe anëtarët e familjes së tij.
- Personi i dyshuar administronte dhe 4 organizata të tjera bamirëse që vepronin në fushat e (ndërgjegjësimit dhe këshillimit – ekologjisë – mirëqenies së grave dhe fëmijëve – edukimit).
- Transaksionet bankare në llogarinë 1, në bankën ‘X’, arrinin në vlerat 239,302 USD dhe 194,292 Euro.
- Transaksionet bankare në llogarinë 2, në bankën ‘X’, arrinin në vlerat 645 USD dhe 22,593 Euro.
- Personi i dyshuar kishte kryer 14 dërgesa në shumën prej 67,874 USD dhe 227,685 Euro drejt vendit ‘S’, me qëllim financimin e projekteve.

Treguesit e dyshimit të lidhur me rastin pasqyrohen në dokumente të falsifikuara, transfertat të mëdha pa një justifikim të dukshëm dhe shumëllojshmëri të aktiviteteve të organizatave të administruara nga personi i dyshuar.

Tipologji nr.8: Trafikimi dhe shfrytëzimi i personave me qëllim mbështetjen dhe financimin e terrorizmit.

NJIF mori raporte për transaksione financiare të dyshimta të lidhura me një shoqatë bamirëse ‘X’, me kryetar të këshillit drejtues shtetasin ‘M’. Arsyeja e paraqitjes së raporteve të dyshimta nga subjekti, lidhej me faktin që shoqata strehonte një grup fëmijësh e të rinjsh në kushte të pafavorshme, që i nënshtroheshin keqtrajtimit dhe shfrytëzimit ekonomik.

Nga shqyrtimi i llogarive të hapura në emër të shoqatës dhe presidentit të saj u konstatua, se llogaria e shoqatës regjistronte vetëm depozita me para në dorë në shumën prej 3,222 USD, ndërsa në llogarinë personale të drejtuesit të shoqatës, ishin kryer një sërë transfertach nga jashtë në shumën prej 310,270 USD. U identifikuan gjithashtu transaksione financiare me përfitues persona ekstremistë të dyshuar për terrorizëm, përveç transfertave të kryera drejt agjencive të udhëtimit dhe organizatave të tjera.

Treguesit e dyshimit të lidhur me rastin pasqyrohen në zbulimin e transfertave të huaja të kryera nga organizata të dyshuara për ekstremizëm, si dhe në identifikimin e transaksioneve të dyshimta financiare me persona fizikë të dyshuar për ekstremizëm dhe terrorizëm, si edhe me agjenci udhëtimit dhe organizata të tjera.

Sipas informacionit të marrë nga organet ligj zbatuese, ‘42 fëmijë dhe 27 të rritur u gjetën të grumbulluar brenda të njëjtit strehim, në kushte që nuk plotësonin kërkesat minimale për shëndet, higjienë dhe siguri, të gjithë jashtë sistemi shkollor, të ekspozuar ndaj dhunës dhe keqtrajtimit, dhe të shfrytëzuar në punë në sektorin e bujqësisë dhe ndërtimit, si dhe të indoktrinuar me ide dhe praktika ekstremiste.’

Pronari i vendstrehimit u ndalua me autorizim të Prokurorisë së Përgjithshme për “trafikim personash, shfrytëzim ekonomik të fëmijëve dhe abuzim të dhunshëm” dhe për “dyshim për përkatësi në një organizatë terroriste”.

Tipologji nr.9: Transferta ndërkombëtare me burim të paqartë dhe kanalizimi i fondeve brënda vëndit tek subjekt apo persona të dyshuar për financim të terrorizmit.

NJIF mori raporte për transaksione financiare të dyshimta të lidhura me shoqatën ‘Y’, aktiviteti i së cilës bazohet në objektiva social dhe bamirësie në kontributin për zbutjen e varfërisë tek personat në nevojë dhe forcimin e frymës së solidaritetit social.

Arsyet për raportimin lidheshin me dyshimin për transfertat bankare të kryera nga shoqata me qëllimin e pretenduar për “financimin e projekteve bamirëse”. Nga shqyrtimi i qarkullimit financiar të shoqatës, rezultoi se burimet e saj të financimit bazoheshin tërësisht në dërgesa nga jashtë, që vinin nga shoqata të vendosura në vendin ‘A’. Këto shuma më pas dërgoheshin drejt shoqatave me karakter fetar të vendosura në rajone të ndryshme të vëndit. U vu re gjithashtu se drejtuesi i shoqatës, ishte kryetar edhe i një shoqate tjetër për të cilën NJIF kishte referuar më herët në organet kompetente për dyshime mbi financim të terrorizmit.

Pas identifikimit të burimeve të qarkullimit financiar të shoqatës, të përbëra tërësisht nga financime të huaja (100% e operacioneve kreditore), u bë e mundur të gjurmohet destinacioni i tyre, duke identifikuar një pjesë të rëndësishme të personave përfitues të këtyre fondeve, si edhe karakteristikat e metodës praktike të përdorur nga drejtuesit e shoqatës, e cila mbështetej në pikat e mëposhtme:

- Shoqata ‘Y’, ishte e lidhur me një rrjet të rëndësishëm burimesh financimi shoqatash në vende të huaja.
- Llogaria e shoqatës ‘Y’, e hapur pranë bankave vendase konsiderohej si një llogari qëndrore për pranimin e fondeve të huaja, me qëllim devijimin e tyre drejt një numri të konsiderueshëm shoqatash me sfond fetar.

– Disa anëtarë të shoqatave ishin të dyshuar për terrorizëm.

Treguesit e dyshimit për këtë rast pasqyrohen në faktin se raporti financiar i shoqatës nuk ishte publikuar në përputhje me dispozitat e legjislacionit për shoqatat, e cila parashikon publikimin e të gjitha ndihmave, donacioneve dhe granteve të huaja. Raporti nuk përmbante burimin, vlerën dhe qëllimin e tyre, përveç dyshimeve në lidhje me disa nga palët e përfshira në ekstremizëm dhe terrorizëm. Komunikimi me NjIF partnere evidentoi ekzistencën e dyshimeve në lidhje me drejtuesin e shoqatës edhe jashtë vendit.